

Nr.regj:37307/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sherafedin Memgju, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 par.1 i sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 02.12.2011 merr këtë:

## A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Sherafedin Adil Memgju ,i lindur me 14.08.1949 ne Prizren,me vendbanim ne Prishtine,rr."Ibrahim Banushi "nr.8,i martuar ,prind i tre femijeve,ka te kryer fakultetin, inxhinier ne Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, dhe jeton ne gjendje te mesme ekonomike.

## E s h t e p e r g j e g j e s

Sepse si zyrtarë e larte –gjegjesisht Drejtor i Bordit ne Termokos-Ngrohtoren e qytetit ne Prishtine, nuk e ka bere deklarimin e pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit,me rastin e marrjes se detyres, ne afatin e caktuar ligjor Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 7 par 1 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

## G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518.Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave –banke,permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata .Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 13 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur,kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €,ne sherbimin e arkes se gjykates. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## A r s y e t i m

**Agjensia Kunder Korrupsionit,Prishtine** parashtroi kërkesen me nr.01/4110/11 më dt. 26,10.2011 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ne baze te kerkeses se parashtruar u inicua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehurin ,i cili deklaroi se ,nuk ka patur njohuri lidhur me obligimin e deklarimit te e pasurise prane Agjensionit Kunder Korrupsionit dhe shton se ne te kunderten i njejti do ta kishte përmbushur nje obligim te tille.

Ne baze te te dhenave ne kerkese,deklarates se te pandehurit, shiqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, Gjykata konstatoi se i

pandehuri e ka kryer kundervajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre,per çka u shpall pergjegjes dhe u denua me gjobe si ne dispozitiv te ketij aktvendimi .

Me rastin e shqiptimit te denimit ,konform nenit 7 te LMK,se ,u moren parasysh te gjitha rrethanat e kryerjes se kundervajtjes,dhe te pandehurit iu shqiptua denimi me gjobe ne lartesine si ne dispozitiv ,duke konsideruar se edhe me kete do te arrihet efekti i sanksionimit ,ashu qe i pandehuri ne te ardhmen tu shmanget kryerjes se veprave te tilla apo te ngjashme kundervajtese .

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrojë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës,Gjykates se Larte per Kundervajtje, në afatin prej 8 ditësh,pas marrjes se ketij aktvendimi,nepermes kesaj gjykate dhe pa taksa

## **VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

Gjyqtarja  
Zajrete Muhaxheri

